

nuk ndjeheshin të sigurt për shkak të afërsisë së fshatit serb Gorazhdec/Gorazhdevac. Ahmeti, vëllai Binaku dhe axha Ukë shkuan në Qyshk/Čuška te farefisi i vet, ndërkaq pjesa tjetër e familjes ka kaluar në Malin e Zi. Nga mesi i muajit korrik të vitit 1998, Ahmeti shkoi në Graboc/Grabovac që t'i ndihmonte UÇK-së në këtë fshat. Ka rënë në betejë me forcat serbe me **15.08.1998** në **Graboc/Grabovac**. Trupi i tij ka mbetur në vendin e betejës. Në regjistrin e KNKK-së, rasti i tij është i evidentuar në lëndën që e mban numrin BLG-803430-01. Pas përfundimit të luftës, UÇK e ka shpallur Ahmetin dëshmor lufte.

Burimet: deklarata B.K, FDH-19717; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Skënder (Haxhi) Çeku

(1.01.1955, shqiptar nga Qyshku/Čuška, komuna e Pejës/Peć, jurist, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Skënderi e ka braktisur Kosovën për shkak të angazhimeve politike, në fillim të viteve të nëntëdhjeta. Ka qëndruar në Zvicër deri në vitin 1998, kur kaloi në Shqipëri, ku iu bashkëngjiti UÇK-së. Një kohë ishte i ngarkuar me trajnimin e ushtarëve të rinj, ndërkaq, më vonë, kaloi në Kosovë. Në datën **15.08.1998**, ai gjendej në **Loxhë/Loda**. U plagos rëndë në betejë me forcat serbe. Bashkëluftëtarët e kanë çuar në spitalin e UÇK-së në Semetishtë/Semetište, ku pas dy ditësh ndërroi jetë. Atje edhe e varrosën. Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të Skënderit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Glllogjan/Glodane. E dekoruan pas vdekje me gradën gjeneral – major.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFUDUÇK, *Feniksët...* 4, 283-285; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Ahmet (Deli) Shala

(15.02.1969, shqiptar nga Loxha/Loda, komuna e Pejës/Peć, bujk, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Valon (Sokol) Shala

(15.08.1977, shqiptar nga Loxha/Loda, komuna e Pejës/Peć, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Valoni ka aderuar në UÇK më 15.05.1998, ndërkaq Ahmeti më 4.06.1998. Në fillim, Ahmeti ishte i ngarkuar me sigurimin e kujdesit për të plagosurit, ndërkaq, më vonë, kaloi në shtabin e UÇK-së në fshatin e vet [Loxhë/Loda]. Në datën **15.08.1998**, pjesëtarët e forcave serbe e kanë sulmuar **Loxhën/Loda**, së pari nga ajri, e pastaj me bombardimet nga drejtimi i Gorazhdecit/Gorazhdevac, Zagërmës/Zagrmlje dhe Deçanit/Deçane. Nga ora 12:00, në fshat hyri këmbësoria serbe. Valoni dhe Ahmeti kanë gjetur vdekjen në luftimet me forcat serbe. Gjatë tërheqjes, forcat serbe i kanë marrë me vete trupat e tyre të pajetë. Ditën tjetër, pas obduksionit, policia i ka dorëzuar trupat e tyre në Bashkësinë Islame në Pejë/Peć, e cila i varrosi ato në varrezat e qytetit të Pejës/Peć. Pas përfundimit të luftës, në përvjetorin e rënies së tyre, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Ahmetit dhe Valonit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës, në Loxhë/Loda.

Burimet: deklarata M.Sh, FDH-19515; deklarata S.H, FDH-36662; KMKKRF, *Personat...*, FDH-10832; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298. 36.13, FDH-30877; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Cyme (Ibish Çeku) Shala

(16.10.1915, shqiptare nga Loxha/Loda, komuna e Pejës/Peć, rrobaqepëse, tetë fëmijë)

Cymja e moshëthyer jetonte te djali Ramadani dhe familja e tij në **Loxhë/Loda**. Në datën 14.08.1998, kaloi në shtëpinë e së bijës Times, e cila jetonte në të njëjtin fshat. Ditën e nesërme, më **15.08.1998**, kur nisi bombardimi i fshatit, ajo, së bashku me vajzën Timen dhe mbesën Mirjetën, filloi të ikte me vrap. Një predhë ka rënë pranë tyre. Të kapluar me panik nga eksplodimi i saj, Timja dhe e bija ikën në drejtim të Dubovikut/Dubovik, duke u ndarë nga Cymja në tollovi që u krijua gjatë bombardimit. Nga ajo ditë e deri në fund të luftës, familjarët nuk dinin asgjë për fatin e Cymes. Vetëm pas lufte, në muajin qershor të vitit 1999, familjarët kanë mësuar se një person i moshuar i gjinisë femërore, i cili kishte pësuar në Loxhë/Loda, ishte varro-